

REPUBLIC OF KOSOVO  
Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit  
Regulatorni Autoritet za Usluge Vode  
Water Services Regulatory Authority

Nr. prot./Pril. B./Pril. No. 275  
Lloji/Tipi/Intencioni DT  
Nr. or. se Ushp. B./Nëq. No. 04/05/2017  
Data/Çës. Eft's



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT  
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE  
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



## Politikat Tarifore për Furnzim të Ujit me Shumicë

Autoriteti Rregullatorë për Shërbimet e Ujit

20 Shkurt 2017

## **Misioni**

**“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efçente të shërbimeve të ujit, për të gjithë konsumatorët në Kosovë”**

## **Vizioni**

**“Regullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikat e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit Publik”**

# Politika Tarifore për Furnizim të Ujit me Shumicë

## Përmbajtja

1.	HYRJE .....	1
1.1	Dispozitat.....	1
1.2	Objektivat .....	1
2.	JURISDIKSIONI.....	2
2.1	Furnizuesi i ujit me shumicë .....	2
3.	OPCIONET KRYESORE TË POLITIKËS TARIFORE.....	2
3.1	Shpërndarja e kostove të sektorit.....	2
3.1.1	Ndërsubvencionet në shumë sektorë.....	2
3.1.2	Uniformiteti i tarifave .....	3
3.1.3	Alokimi i shpenzimeve për shërbimet .....	3
3.1.3	Arsyeshmëria e tarifave .....	3
3.2	Faktorët mjedisor.....	4
3.2.1	Kontrolli mbi shfrytëzimin e ujit.....	4
3.2.2	Taksa për marrjen e ujit.....	4
3.3	Mbulimi i kostos.....	4
3.3.1	Definicioni .....	4
3.3.2	Koha e duhur për arritjen e mbulimit të plotë të kostos.....	5
3.3.3	Pritjet e efijencësi .....	5
3.3.4	Mbulimi i kostove kapitale të investimit .....	6
3.3.5	Grantet dhe asetet e dhuruara .....	6
3.4	Struktura e kapitalit, vlera dhe kthimi në kapital .....	7
3.4.1	Struktura e kapitalit, vlera dhe kthimi në kapital.....	7
3.4.2	Baza rregullatore e aseteve .....	7
3.4.3	Kthimi në kapital.....	8
3.4.4	Procesi i vënies së taksave .....	8
4.	PROCESI.....	9
4.1	Shqyrtimet kryesore të tarifave .....	9

## 1. HYRJE

### 1.1 Dispozitat

Dispozitate përcaktimit të tarifave bazohen në Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe Rregulloren e ARRU-së Nr. 07/2016 për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimeve të Ujit në Kosovë.

Kjo politikë e lëshuar nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) paraqet interpretimin dhe elaborimin e obligimeve ligjore lidhur me tarifën e rregulluar për shërbimet e furnizimit të ujit me shumicë.

Veçanërisht, sipas Nenit 47 të Ligjit ARRU (*Rregulloret e nxjerra nga Autoriteti*) kërkohet që ARRU të nxjerr të gjitha rregulloret dhe formularët e kërkuara sipas këtij ligji për vendosjen dhe aprovimin e tarifave. Kjo politikë është bazë mbi të cilën vendosen rregullat e tilla të detajizuara.

Neni 20 i Ligjit të ARRU-së përshkruan obligimet e caktuara të vënies së tarifave duke përfshirë:

- Pritjet e efijencës (3.2)
- Mjaftueshmërinë për përmbushjen e kostove kapitale dhe kostove tjera (3.4)

Obligimet ligjore siç është paraparë në Ligjin ARRU, lejojnë një shkallë të diskrecionit rregullativ të bazuar në gjykimin profesional, kuptimin e entiteteve rregullative (dhe rrethanave specifike të tyre) dhe kriterin socio-ekonomik.

Me marrjen parasysh të pikëpamjeve të palëve të interesit është përgatitur ky draft përfundimtar i politikës tarifore.

### 1.2 Objektivat

Interesat e palëve të ndryshme të interesit nuk përputhen domosdoshmërisht; për shembull interesat e konsumatorit për të pasur tarifa të ulëta janë kontradiktore me interesat e investitorëve në qëndrueshmërinë financiare. Është detyrë e ARRU-së të përcaktojë tarifa të cilat ofrojnë një balanc optimal në mes të këtyre interesave dhe vlerë më të mirë të mundshme duke përfshirë çmimin dhe kualitetin e përmirësuar të shërbimit për shoqërinë. Kjo politikë tarifore është përpiluar në atë mënyrë që të sigurojë balancimin më të mirë të mundshëm.

## 2. JURISDIKSIONI

### 2.1 Furnizuesi i ujit me shumicë

Ligji i ARR U-së është specifik në përkufizimin e *Furnizuesit të Ujit me Shumicë (FUSH)* i cili furnizon Ofruesin e Shërbimeve regjionale të ujit. Ligji aktual ARR U përjashton ofrimin e furnizimit të ujit me shumicë për çështje industriale dhe pranuesve tjerë të shërbimeve të tilla. Kështu që, kjo politikë tarifore është e kufizuar në procesin e vendosjes së tarifave për ujin e ofruar shtatë ofruesve të licencuar të ujit nga ARR U. Uji me shumicë i cili ofrohet për shfrytëzuesit e tjerë është aktivitet i parregulluar komercial dhe tarifat i nënshtrohen marrëveshjes në mes të palëve të prekura.

#### FUSH 1: Jurisdiksioni

Kjo Politikë Tarifore zbatohet për furnizim të ujit me shumicë të ofruesve të licencuar të shërbimeve të ujit (KRU-ve) nga ARR U. Kjo nuk zbatohet për ujin me shumicë i cili usigurohet palëve tjera.

## 3. OPCIONET KRYESORE TË POLITIKËS TARIFORE

### 3.1 Shpërndarja e kostove të sektorit

#### 3.1.1 Ndërsubvencionet në shumë sektorë

Ligji ARR U-së konstaton që tarifat duhet të përcaktohen duke pasur parasysh 'mjaftueshmëria e tarifës për të mbuluar shpenzimet e operimit dhe të mirëmbajtjes të ofruesit të shërbimeve dhe të ndonjë plani të ofruesit të shërbimeve për shpenzime kapitale nëse ato dokumentohen se janë në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të cilat janë miratuar nga Autoriteti'. ARR U ndalon e çfarëdo forme të ndërsubvencionimit në mes të sektorëve të ndryshëm që marrin shërbime nga ofruesi i shërbimit të ujit me shumicë. Dihet se tarifat e ndryshme të aplikuara në sektorë të ndryshëm do të rezultojnë kthimet e dallueshme të furnizuesëve të ujit me shumicë. Megjithatë, tarifat e përcaktuara nga ARR U të ujit me shumicë duhet të vendosen në nivelet që reflektojnë, sa të jetë e mundur kostot e vërteta të furnizimit, pavarësisht nga tarifat e aplikuara në sektorët e tjerë.

#### FUSH 2: Ndërsubvencionet në shumë sektorë

Tarifat duhet të vendosen për të reflektuar kostot e vërteta të furnizimit dhe nuk duhet të lejohen për çfarëdo efekti të ndërsubvencionimit.

### 3.1.2 Uniformiteti i tarifave

Mendohet se kosto e furnizimit të ujit me shumicë ndryshon dukshëm varësisht nga lokacioni i pikës së furnizimit brenda sistemit të infrastrukturës së furnizimit të ujit me shumicë. Kështu që nuk është e përshtatshme të aplikohen tarifa uniforme të ujit me shumicë tek të gjithë ofruesit e shërbimit të furnizimit të ujit por tarifatat të jenë të ndara për çdo ofrues që reflektojnë kostot e furnizimit në secilën pikë të furnizimit.

#### FUSH 3: Uniformiteti i tarifave

Aplikimi i tarifave uniforme për të gjithë ofruesit e shërbimeve nuk është i përshtatshëm. Tarifatat duhet të vendosen për të reflektuar kostot e furnizimit në pikën e marrjes së ujit në sistemin e ofruesit të shërbimit me shumicë.

### 3.1.3 Alokimi i shpenzimeve për shërbimet

Gjatë procesit tarifor apo rishikimit vjetor të tarifave, furnizuesi i ujit me shumicë duhet të alokojë qartë dhe në mënyrë transparente shpenzimet dhe investimet që dedikohen vetëm për dërgimin e ujit me shumicë tek ofruesi i shërbimit. Në bashkrendim me Autoritetin, furnizuesi i ujit me shumicë duhet të kategorizojë dhe ndajë shpenzimet që dedikohen për prodhim të energjisë, ujten e tokave, ujin për termoelektrana, etj.

#### FUSH 4: Alokimi i shpenzimeve

Furnizuesi i ujit me shumicë duhet të alokojë qartë dhe në mënyrë transparente shpenzimet dhe investimet që dedikohen për dërgimin e ujit me shumicë.

### 3.1.4 Arsyeshmëria e tarifave

Në rastet kur furnizuesit të ujit me shumicë i paraqitet ndonjë kërkesë për një pikë shtesë të furnizimit të ujit me shumicë, me ç'rast rritet sasia e ujit që u dërdohet ofruesëve të shërbimeve, atëherë tarifatat e ujit me shumicë duhet të mbulojnë të gjitha shpenzimet dhe investimet duke marrë për bazë edhe sasinë e rritur të ujit të shitur. Kjo nënkupton se shtimi i pikave të reja të furnizimit të ujit me shumicë ndikon edhe në pikat tjera në të cilat furnizuesi i ujit me shumicë ka realizuar furnizimet e veta të ngjashme..

**FUSH 5: Arsyeshmëria e tarifave**

Tarifat e ujit me shumicë duhet të mbulojnë të gjitha shpenzimet dhe investimet kapitale për dërgimin e ujit tek ofruesi i shërbimit. Në rastet kur rritet sasia e ujit të dërguar tek ofruesi i shërbimit (pika të reja të furnizimit) gjatë kalkulimit të tarifës duhet të reflektohet edhe sasia shtesë e ujit të shitur, e cila ndikon edhe në pikat tjera të furnizimit të ujit me shumicë.

## 3.2 Faktorët mjedisor

### 3.2.1 Kontrolli mbi shfrytëzimin e ujit

Nuk ka arsye të imponimit të tarifave të menaxhimit të kërkesës për furnizim të ujit të papërpunuar dhe për këtë kjo nuk përkrahet.

**FUSH 6: Strukturat e tarifave të menaxhimit të kërkesës**

Strukturat e tarifave të menaxhimit të kërkesës për furnizim të ujit me shumicë nuk mbështeten nga ARRU.

### 3.2.2 Taksa për marrjen e ujit

Furnizuesi i ujit me shumicë i paguan Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) taksat për marrjen e ujit të papërpunuar. ARRU përkrahë imponimin e taksave të tilla duke pasur parasysh përmbushjen e kostos ekonomike të ujit e cila duhet edhe jetë nxitje për të reduktuar humbjet e ujit

**FUSH 7: Taksat për marrjen e ujit të papërpunuar**

Taksat për marrjen e ujit të papërpunuar mbështeten nga ARRU.

## 3.3 Mbulimi i kostos

### 3.3.1 Definicioni

Mbulimi i kostos në sektorin e ujit i nënshtrohet përkufizimeve të ndryshme. ARRU mendon që mbulimi i kostos duhet të jetë i mjaftueshëm që ofruesi i shërbimeve t'i financojë aktivitetet e tija

dhe të fitojë kthim të kapitalit të cilin e investon. Metodologjia e hollësishme do të paraqesë mekanizmin për përcaktimin e tarifave që mund të arrijë këtë qëllim përmes zhvillimit të udhëzuesve të kontabilitetit rregullator. Kjo do të përfshijë adoptimin e qasjes së 'menaxhimit të aseteve' në mirëmbajtjen e kapitalit të aseteve nëntokësore lidhur me praktikën e mirë rregullatore. Është e drejtë e ARRU-së për të marr vendime për formën e mbulimit të kostove.

**FUSH 8: Përkufizimi i mbulimit të kostos**

Mbulimi i kostos përkufizohet si rrjedhje e të hyrave të mjaftueshme për të financuar aktivitetet e ofruesve të shërbimeve si dhe për kthim të arsyeshëm të kapitalit i cili investohet.

**3.3.2 Koha e duhur për arritjen e mbulimit të plotë të kostos**

Me marrjen e pozicionit inicues në hapjen e vlerës-bazës rregullatore të aseteve (BRRa) mbi të cilën mundësohet kthimi në kapital, është e mundur të krijohet Asetet jo infrastrukturore (mbitokësore) që u janë dhuruar ofruesëve të shërbimeve nuk duhet të futen në bazën rregullatore të aseteve dhe kështu nuk duhet të kenë kthim në kapital. Me rastin e zëvendësimit të këtyre aseteve me investimeve vetanake të ofruesit të shërbimeve, BRRa dhe kthimi në kapital duhet të mundësohet me kalimin përgjatë viteve.

**FUSH 9: Afati kohor për arritjen e mbulimit të kostos**

Mbulimi i kostos duhet të arrihet menjëherë në bazë të asaj që të jetë i mjaftueshëm për të financuar aktivitetet e ofruesve të shërbimit, por norma e kthimi në kapital duhet të rritet në mënyrë progresive në kohën e ndërmarrjes së investimeve të reja në sektor për përmirësim të shërbimeve apo për zëvendësimin e aseteve të investuara nga donacionet që aktualisht nuk konsiderohen si pjesë e bazës rregullatore të aseteve.

**3.3.3 Pritjet e efijencësi**

Tarifat duhet të reflektojnë pritjet reale dhe sfiduese të shkallës së arkëtimit nga ofruesit e shërbimit të ujit me shumicë.

**FUSH 10: Pritjet e përmirësimit të shkallës së arkëtimit**

ARRU duhet të vendos pritjet e përmirësimit të shkallës së arkëtimit në konsultim me ofruesit e shërbimit të ujit me shumicë. Caqet duhet të jenë reale por megjithatë sfiduese.

### 3.3.4 Mbulimi i kostove kapitale të investimit

Me zbatimin e qasjes së menaxhimit të aseteve, ARRU duhet të aplikojë metodologjitë e ndryshme për mbulimin e investimeve kapitale. Parimet themelore janë:

- Amortizimi nuk duhet të aplikohet në grantet e financuara apo asetet e dhuruara ose, përndryshe duhet të balancohet me amortizimin e njëjtë të vlerës së aseteve ose granteve.
- Investimet e reja për përmirësimin e shërbimeve duhet të përfshihen në bazën rregullatore të aseteve por amortizimi duhet të ngarkohet vetëm për asetet mbitokësore jo infrastrukturore dhe nuk duhet të ngarkohet për asetet infrastrukturore (asetet nëntokësore plus pendat dhe kanalet) ku vlerat e tyre duhet të jenë afatgjate.
- Mirëmbajtja kapitale (riparimi dhe zëvendësimi) e infrastrukturës duhet të konsiderohet si shpenzim me të cilat ngarkohen tarifat bazuar në planet e menaxhimit të aseteve.
- Nëse ofruesit e shërbimeve kenë të drejtë në normen e kthimit të investimeve në infrastrukturë dhe se mirëmbajtja e kapitalit është e përfshirë në shpenzime, atëherë nuk ka arsye të arsyeshme që amortizimi të merret parasyh në asetet e tilla.
- Kudo që përfshihet amortizimi, ai duhet të llogaritet mbi bazën e shpenzimeve aktuale të cilat duhet të bazohen në shpenzimet historike të korigjuara përmes formulës së thjeshtë të Raportit Periodik të Indeksimit derisa nuk zhvillohet një qasje më e përshtatshme.

#### **FUSH 11: Mbulimi i kostove kapitale të investimeve**

Nëse ofruesit të shërbimeve i lejohet norma e kthimit në kapital me anë të aplikimit të qasjes së menaxhimit të aseteve dhe nëse mirëmbajtja e kapitale e infrastrukturës konsiderohet si shpenzim, atëherë nuk është e arsyeshme që norma e amortizimit të aplikohet në asetet jo të infrastrukturës.

### 3.3.5 Grantet dhe asetet e dhuruara

Furnizuesi i ujit me shumicë nuk duhet t'i kompenzoj investimet të cilat nuk i ka financuar, p.sh. grantet dhe asetet e dhuruara. Si pasojë e kësaj, amortizimi i aseteve të

tilla nuk duhet të përfshihet në tarifa. Në mënyrë të ngjajshme, mirëmbajtja kapitale në asetet e infrastrukturës të financuara nga grantet nuk e ngarkojnë tarifën.

**FUSH 12: Trajtimi i granteve dhe asetëve të dhuruara**

ARRU duhet t'i trajtojë asetet e siguruara nga grantet dhe asetet e dhuruara në mënyrë të ndryshme nga asetet e financuara përmes resurseve financiare të ofruesve të shërbimeve. ARRU duhet t'i aplikojë rregullat për amortizimin që në mënyrë të drejtë reflekton kthimin në kapital të investuar dhe në pajtim me konceptin e menaxhimit të asetëve.

### 3.4 Struktura e kapitalit, vlera dhe kthimi në kapital

#### 3.4.1 *Struktura e kapitalit, vlera dhe kthimi në kapital*

Teoria ekonomike konvencionale tregon se struktura e kapitalit nuk ka kurfarë ndikimi në performancën e biznesit dhe si e tillë është çështje e menaxhimit të ofruesve të shërbimit të furnizimit të ujit me shumicë e jo çështje rregullative. Kështu që kthimi në kapital (kur të zbatohet) duhet të bazohet në kthimin e vlerës totale të kapitalit duke përfshirë edhe vlerën e borxhit.

**FUSH 13: Struktura e kapitalit**

Struktura e kapitalit të ofruesve të shërbimeve duhet të përfshihet në procesin e vendosjes së vlerës origjinale rregullatore kapitale të asetëve mbi të cilin mund të arrihet kthimi në kapital.

#### 3.4.2 *Baza rregullatore e asetëve*

Baza rregullatore e asetëve (BARRA) përkufizohet si vlera e asetëve mbi të cilën lejohet kthimi në kapital. Baza rregullatore e asetëve duhet të llogaritet si:

- Vlera e borxhit plus kapitali i punës plus investimet e financuara përmes burimeve financiare të ofruesve të shërbimeve (me përjashtim të borxhit) plus vlera nominale e asetëve (që mund të jetë zero) të mbetura (dhuruara).

Ose

- Vlera nominale e përcaktuar nga ARRU për të reflektuar margjinat e fituara nga ofruesi i shërbimit të ujit me shumicë me anë të aplikimit të kthimit të 'drejtë' të kapitalit.

Investimi pasues (duke përjashtuar mirëmbajtjen e aseteve të infrastrukturës) pa amortizim (i llogaritur mbi bazën aktuale të kostos) duhet të përfshihet në bazën rregullatore të aseteve. Në pajtim me konceptin e menaxhimit të aseteve, BRRRA duhet të përshtatet për inflacion gjatë shqyrtimeve periodike të tarifave.

**FUSH 14: Baza rregullatore e aseteve (BRRRA)**

ARRU duhet të krijojë vlerën e hapur të bazës rregullatore të aseteve (BRRRA) për secilin ofrues të shërbimeve të bazuar në nivelin e borxhit dhe investimet e bëra nga burimet financiare të ofruesve të shërbimit.

**3.4.3 Kthimi në kapital**

Furnizuesit e ujit me shumicë duhet të kenë të drejtën për kthimin e bazuar dhe të arsyeshëm në kapital. Norma e kthimit duhet të përcaktohet në bazë të kthimit me rrezikun e caktuar përmes aplikimit të Modelit Tarifor të Aseteve Kapitale (MTAK) ose ngjajshëm. Në mungesë të të dhënave të duhura të tregut, ARRU mund të përdorë të dhëna zëvendësuese, p.sh. tarifën 'pa rrezik' për bondet e thesarit të Euro-zonës plus rrezikun shtetëror plus rrezikun e premieeve për sektorin e ujit, p.sh. si është përcaktuar nga OFWAT në përcaktimet e tyre të tarifave.

**FUSH 15: Kthimi në kapital**

ARRU duhet të përcaktoj kthimin e duhur në bazën rregullatore të aseteve të ofruesve të shërbimeve. Kjo duhet të përcaktohet në bazë të tarifës pa rrezik/plus rrezikun e sektorit dhe premiumet e përshtatshme të rrezikut shtetëror.

**3.4.4 Procesi i vënies së taksave**

Tarifat duhet t'i reflektojnë taksat e pakompensueshme kudo që është nevoja. Kudo që aplikohen taksat, ato duhet t'i ngarkohen tarifave dhe kthimi në kapital duhet të bazohet mbi kthimin e "post-taksës" me vlerën e taksës të përfshirë në kosto.

**FUSH 16: Procesi i vënies së taksave**

Taksat e pa-kompensueshme duhet të përfshihen në tarifa.  
Kthimi në kapital duhet të përcaktohet mbi bazën e 'post-taksës'.

## 4. PROCESI

### 4.1 Shqyrtimet kryesore të tarifave

#### FUSH 17: Shqyrtimet kryesore të tarifave

Tarifat mund të përcaktohen mbi bazën vjetore të tyre. Politika tarifore mund të përpilohet me një grup të kompletuar të rregullave që mundësojnë periudhat më të gjata në mes të shqyrtimeve.

Në bazë të Politikave Tarifore të KRU-ve, ARRU mund të aplikojë politika të njëjta edhe për shërbimin e furnizimit të ujit më shumicë të pa trajtuar.

### 4.2 Shqyrtimet e përkohshme

Në pajtim me Ligjin ARRU nr. 05/L-042-së, neni 20, ARRU duhet t'i shqyrtoj tarifat çdo vit ose 'nëpër periudha të tjera kohore të cilat caktohen në pajtueshmëri me Ofruesin e Shërbimeve..ARRU duhet të vendos tarifa në mënyrë periodike me shqyrtim vjetor të kërkuar nga rregullorja e kufizuar në rregullimin e inflacionit dhe rasteve tjera të jashtëzakonshme.

#### FUSH 18: Shqyrtimet e përkohshme

ARRU duhet të bëjë shqyrtime të përkohshme periodike të tarifave duke marrë parasysh infacionin dhe ndryshimet e pazakonshme në mjedisin operativ.